

AKTI I THEMELIMIT
i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
“Smart Self Service” sh.p.k

Në Tiranë, sot më datë 04/09/2025 (dymijë e njëzetë e pese), midis:

- 1- Orbit shpk, me numer NIPT-i M12220005C, me seli ne adresen: Njesia Administrative Nr. 9, Rruga Karl Gega, Zona Kadastrale 8340, kati pare, Tirane, e perfaqesuar ligjerisht nga Z. Edmond Liçaj, shtetas shqiptar, i biri i Mexhit, lindur me 01/06/1989 në Peshkopi, banues në Tiranë, nr. personal I90601002F, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili zoteron 100% te aksioneve dhe eshte administrator i kompanise.
- 2- Paragon shpk, me numer NIPT-i M22211029E, me seli ne adresen: Rruga Tre vellezërit Kondi, Tirane, e perfaqesuar ligjerisht nga Z. Klodjan Bregu, shtetas shqiptar, i biri i Veip, lindur me 30/03/1981 në Skrapar, banues në Tiranë, nr. personal I10330074T, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili zoteron 100% te aksioneve dhe eshte administrator i kompanise.

Në vijim referuar së bashku si **“Ortaket”**.

Palet e sipërcituara përpilojne këtë akt themelimi, nëpërmjet të cilit deklarojne me vullnetin e tyre të lirë, të plotë dhe në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, me ligjin 9901 datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, me ligjin 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, me atë të ligjit Doganor, Fiskal e Tatimor, dhe Autoritetit përkatës sipas objektit të shoqërisë, se krijojne Shoqërinë Tregtare të Kufizuar, **“Smart Self Service sh.p.k”**.

KREU I

Neni 1
Krijimi

Shoqëria **“Smart Self Service” sh.p.k** është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (më poshtë referuar si **“Shoqëria”**).

Neni 2
Personaliteti Juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria **“Smart Self Service” sh.p.k.** është një shoqëri tregtare, e themeluar nga Ortaket te cilet gëzojne kuotat e tyre në shoqëri, në përpjestim me kontributin e dhënë në kapital. Kontributi i Ortakeve përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë. Ortaket e shoqërisë mbulojne personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Ortaket e shoqërisë nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë, në rastin kur i kanë shlyer të gjitha kontributet e tyre.



Neni 3

Selia

Shoqëria do ta kete selinë në Tiranë, Shqipëri, me adresë: Rruga:Thoma Koxhaj, Yzberisht, Tirane. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendimin e Ortakeve.

Neni 4

Objekti i Veprimtarisë

Shitje me makineri automatike. Magazinim te produkteve ushqimore. Perpunim, prodhim, ambalazhim, paketim si dhe tregti me pakice dhe shumice te produkteve ushqimore. Import-eksport te tekstileve dhe nenprodukteve te tyre ne Republiken e Shqiperise, Import-eksport i materialeve te ndertimit, pajisjeve elektrike dhe elektronike, etj.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohe të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njqind mije) ALL, i ndarë në 2 kuota, ku ortaket zotërojnë kuotat e mëposhtme të kapitalit të Shoqërisë:

- 1- Ortaku Orbit shpk, me numer NIPT-i M12220005C, zoteron 1 kuote ne masen 50% te kapitalit themeltar me vlere 50.000 (pesedhjetë mije) leke.
- 2- Ortaku Paragon shpk, me numer NIPT-i M22211029E, zoteron 1 kuote ne masen 50% te kapitalit themeltar me vlere 50.000 (pesedhjetë mije) leke.

Ortaket përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7

Transferimi i Kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;



- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarrës

Organet Vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- 1- Asambleja e Përgjithshme;
- 2- Administratori.

Shoqëria ka të drejtë që në të ardhmen të shtojë organet e saj, siç mund të jetë Këshilli Administrativ.

Neni 9

Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.



Neni 10

Administrimi

Administrator i shoqërisë është Z. Julian Hoxha, i biri i Tefik, lindur më 08.11.1989, në Berat, banues në Tiranë, nr. personal I91108001B, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i emëruar në këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecuresë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson shoqërinë përpara të gjithë personave fizikë e juridikë, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 11

Viti Financiar

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB dhe mbyllet me 31 Dhjetor.



Neni 12

Shpërndarja ose Prishja e Shoqërisë

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Asambleja e Përgjithshme merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe duke shënuar në çdo dokument të nxjerrë, emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Neni 13

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 14

Dispozitat Përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 3 ekzemplarë në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

Akti i mësipërm u miratua në parim dhe nen për nen nga Ortakët themelues të **shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "Smart Self Service"**, dhe nënshkruhet nga të gjithë Ortakët themelues në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën origjinale.

ORTAKET

Per Orbit shpk

Administratori

Edmond Liçaj



Per Paragon shpk

Administratori

Klodjan Bregu

